



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e UMT-së (përfshirë adresën postare / elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).

Çdo person, në rast se është i interesuar, ka të drejtë të bëjë një kërkesë ose ankesë, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejt me veprimet ose mosveprimet e UMT-së, ose shërbimet e ofruara prej tij.

Kërkesa apo ankesa me anë të së cilës personi/ i interesuari i drejtohet UMT-së, mund të bëhet me shkrim dhe të depozitohet dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar pranë Zyrës së Protokollit për regjistrim, në adresën e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë: Rruga e Dibrës, Nr. 371, AL1005, Tiranë, Shqipëri.

Një tjetër formë e komunikimit me administratën e universitetit, është adresa zyrtare e e-mail-it të UMT-së, për marrjen e informacionit: info@umed.edu.al.

Adresa zyrtare e universitetit menaxhohet nga Sektori i Koordinimit Institucional, i cili, si rregull brenda 48 orëve nga dërgimi i e-mail-it në këtë adresë, e përcjell për trajtim në drejtorinë përkatëse në Rektoratin e UMT-së, ose fakultetin në rast se personi që e ka dërguar është student në një prej tre fakulteteve të UMT-së.

Posta elektronike përdoret si mjet i komunikimit zyrtar dhe çdo informacion i shpërndarë nëpërmjet saj konsiderohet se është marrë nga ana e strukturave përkatëse të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Kërkesa/ankesa duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme në drejtim të përmbajtjes së saj. Gjithashtu i interesuari që depoziton një kërkesë / ankesë, duhet të vendos adresën e tij, numër kontakti apo adresë e-mail-i me qëllim që UMT-ja ti kthejë përgjigje.